



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 23 qershor 2020**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1263\_2020**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Bazuar në:**

- Dispozitat e Nenit 15, dhe Dispozitat e Nenit 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 8 Paragrafët 4, 8 dhe 11 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Nenin 7, paragrafi 7.2 i Rregullës dhe Metodologjisë për përgatitjen e Bilanceve të Energjisë Elektrike dhe Termike;
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 18.05.2020 për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit: Bilanci i Rishikuar Vjetor i Energjisë Elektrike 2020;

**në seancën e mbajtur me datë 23 qershor 2020, nxori këtë:**

## **VENDIM**

**I. MIRATOHET dokumenti Bilanci i Rishikuar Vjetor i Energjisë Elektrike 2020**

### **Arsyetim**

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 18.05.2020 ka pranuar nga KOSTT kërkesën për aprovim të dokumentit **Bilanci i Rishikuar Vjetor i Energjisë Elektrike 2020**. Bazuar në dokumentin Rregulla dhe Metodologjia për Përgatitjen e Bilanceve të Energjisë elektrike dhe termike, nenin 7, paragrafi 7.2 – *Rishikimi i bilancit vjetor të energjisë elektrike*, palët kanë të drejt të kërkojnë rishikimin e bilancit të energjisë elektrike nëse ndryshimi i parashikimeve për prodhim kalon vlerën për 15 % ose nëse ndryshimi i parashikimeve për konsum kalon vlerën për 10%.
- KEK, pas ndryshimeve të paraqitura në planin e remonteve si rezultat i mbylljes së kufijve për

**Vendim – Bilanci i Rishikuar Vjetor i Energjisë Elektrike 2020**

**1**

Adresa: Rr. Dërvish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: [info@ero-ks.org](mailto:info@ero-ks.org), web: [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org)



shkak të virusit COVID 19, fillimisht me datë 17 mars 2020 pastaj me 03 prill 2020 dhe së fundi me 29 prill 2020 ka dërguar në KOSTT kërkesë për rishikim të bilancit vjetor 2020.

- KOSTT pas konsultimeve me ZRRE ka përgatitur dokumentin e rishikuar dhe ka dërguar ne ZRRE me datë 18.05.2020 për analizim dhe aprovim. ZRRE ka analizuar dokumentin, ka dhënë komentet e veta në formë të shkruar të cilat komente janë përfshirë si dhe janë sqaruar çështjet e ngritura në biseda telefonike dhe takime të drejtpërdrejta.
  - Bazuar në Nenin 8 të Ligjit për Energjinë, ZRRE pas analizimit të dokumentit përfundimtar konsideron se dokumenti i përmbush kriteret për miratim, dhe duke marrë parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje të vendimit, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi duke miratuar dokumentin **Bilanci i Rishikuar Vjetor i Energjisë Elektrike 2020**.
- II. Në zbatim të nenit 42, paragrafi 2.1 dhe 2.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Zyra e Rregullatorit për Energji do të monitoroj implementimin e Bilancit të Rishikuar Vjetor të Energjisë elektrike për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në Bilanc.
- III. Bilanci i rishikuar do të publikohet në faqen zyrtare të ZRRE-së si dokument unik i ZRRE së bashku me Bilancin e energjisë termike 2020.
- IV. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti i përbashkët si Bilanci vjetor i energjisë elektrike dhe energjisë termike.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:


- **Bilanci i Rishikuar Vjetor i Energjisë Elektrike 2020**

Vendimi i dërgohet:



- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

**Bordi i ZRRE-së,**

  
Arsim Janova, u.d. Kryesues

  
Besim Bejjaj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar